



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI I KOMPETENCAVE VENDORE DHE FUNKSIONEVE TE
DELEGUARA

Nr. 8657 Prot.

Elbasan më 5.8. 2025

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT BASHKIAK LIBRAZHD

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, i ndryshuar, pas verifikimit të ligjshmërisë së aktit tuaj nr.62 datë 29.07.2025 “Mbi Miratimin e planit vendor për barazinë gjinore për periudhën Shtator-2025- Shtator 2028”, konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.



PREFEKTI

Ilir BEJTJA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHDI
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Datë.31.07.2025

Nr.5206prot

Nr.62 dt.29.07.2025

**MBI MIRATIMIN E PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE
PËR PERIUHDËN SHTATOR 2025- SHTATOR 2028**

-Qëllimet strategjike dhe objektivat specifik

Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore 2025 - 2028 për Bashkinë Librazhd, është përgatitur duke synuar të vendosë promovimin e fuqizimit të grave dhe arritjes së barazisë gjinore në zemër të konceptit të vetëqeverisjes vendore. Në këtë kuadër, qëllimet strategjike dhe objektivat specifike të renditura në vijim, janë formuluar në mbështetje të vizionit të Bashkisë Librazhd për të mundësuar që *gratë dhe burrat, të rejtat dhe të rinjtë, vajzat dhe djemtë e Librazhdit, pavarësisht moshës, karakteristikave personale, nevojave të veçanta, grupit etnik e social, përkatësisë fetare, orientimit seksual apo identitetit të tyre gjinor, njohin, pranojnë dhe respektojnë parimin e barazisë në të gjitha fushat e jetës.*

PVVBGJ 2020-2023 përmban **dy** qëllime strategjike dhe **gjashtë** objektiva specifike
Qëllimi Strategjik 1: Përmbushja e angazhimit publik zyrtar të Bashkisë Librazhd ndaj parimit të barazisë ndërmjet grave dhe burrave në jetën vendore

Objektivat specifikë:


- 1.1. Të ndërmerren veprime konkrete për të raportuar publikisht dhe rregullisht mbi përparimin e Bashkisë Librazhd për të siguruar në praktikë barazinë ndërmjet grave dhe burrave në jetën vendore
- 1.2. Të fuqizohet mekanizmi institucional vendor për arritjen e barazisë gjinore
- 1.3. Të rritet pjesëmarrja e grave dhe të rejave me prejardhje dhe nga grupmosha të ndryshme në të gjitha takimet dhe dëgjuesat publike të organizuara nga Bashkia Librazhd

Qëllimi Strategjik 2: Ofrimi i shërbimeve cilësore dhe të përshtatura sipas nevojave të grupeve të caktuara në komunitet, përmes promovimit të parimit të barazisë ndërmjet grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, si dhe vajzave dhe djemve në aksesin dhe cilësinë e shërbimeve të ofruara

Objektivat specifikë:

- 2.1. Të riorganizohet dhe fuqizohet sektori i shërbimeve sociale në bashki, duke u transformuar në drejori, me njësitë përkatëse siç kërkohen në bazë të legjislacionit për ofrimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror
 - 2.2. Të rritet efektiviteti i qasjes shumë-sektoriale dhe shërbimeve bazë të specializuara për viktimat/të mbijetuarat/it e dhunës me bazë gjinore, dhunës në familje dhe trafikimit të qenieve njerëzore
 - 2.3. Të transformohen lagjet e Librazhdit në hapësira të sigurta publike për gratë, të rejtat, vajzat, djemtë, të rinjtë dhe burrat nga të gjitha grupet shoqëror
3. Ndjek zbatimin e këtij vendimi Sektori I Shërbimeve Sociale, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

SEKRETAR I KËSHILLIT
Elson MALLUTA



ZV/KRYETARE E KËSHILLIT
Silvana HOXHA

